



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Ac.nr.9805/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtarja individuale Frosina Sylejmani, me bashkëpunëtorin profesional Kastriot Makolli, në çështjen juridike – përmbarimore të kreditorit T.K Sh.A, me seli në Prishtinë, kundër debitorit M.Gj nga K. – Komuna G. të cilin e përfaqëson A.Gj avokat në Prishtinë, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.162/19 të datës 15.10.2021, me datë 29.01.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit T.K Sh.A, me seli në Prishtinë ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.162/19 të datës 15.10.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me aktvendimin PPP.nr.162/19 të datës 15.10.2021, në pikën I të dispozitivit ka aprovuar tërësisht si të bazuar prapësimin e debitorit M.Gj nga K. –Komuna Glllogoc, në pikën II ka anuluar në tërësi Urdhrin Përmbarimor të përmbaruesit privat Isak Shala P.nr.54/19 i datës 26.04.2019, në pikën III ka obliguar kreditorin T.K Sh.A me seli në Prishtinë që debitorit M.Gj t'ia paguaj shumën prej 156,00 euro në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktvendimit në emër të shpenzimeve të procedurës përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori T.K Sh.A me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar ashtu që të ndryshohet aktvendimi i ankimuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim i Përmbaruesit Privat P.nr.54/19 i datës

24.04.2021 ose të prishet aktvendimi i ankimuar dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar debitori.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore (LPP), ka gjetur se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbareuesi Privat, Isak Shala, me Urdhrin Përmbaremore, P.nr.59/19 të datës 26.04.2019, ka lejuar përmbareimin e propozuar nga kreditori kundër debitorit, lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej 102.04 euro, në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës //////////////të datës 05.12.2018, me kamatëvonesë prej 8%, duke filluar nga dita e kalimit të afatit për pagesë si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore.

Kundër këtij urdhri mbi lejimin e përmbareimit, brenda afatit ligjor, debitori përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur prapësim, duke theksuar dokumenti në bazë të së cilit është marrë urdhri përmbareues nuk ka tipare të përmbareueshmërisë sepse fatura me numër ////////////// në të cilën thirret kreditori është nule në aspektin përmbaremore (nuk është dokument i besueshëm) sepse nuk elementet që duhet t'i ketë çdo faturë. Ka shtuar se fatura është lëshuar në dhjetorit të vitit 2018 për periudhën e vitit 2017 dhe atë pa marrë shërbimet e kontraktuara. Më tej ka theksuar se as fatura ////////////// e as faturat tjera në të cilat thirret kreditori nuk përmbajnë nënshkrimin e debitorit – pra faturat e lartcekura nuk janë pranuar nga i njëjti. Tutje i autorizuari i debitorit ka theksuar se në rastin konkret ka skaduar afati kohor brenda të cilit mund të kërkohet përmbareimi – pra kërkesa e kreditorit është parashkruar për shkak të kalimit të më shumë se 1 viti nga data e arritjes për pagesë të kërkesave, ndërsa Urdhri për Përmbareim është nxjerrë vonë dhe atë me datë 26.04.2019, rrjedhimisht kërkesa është parashkruar sipas nenit 360 par.2 të LMD-së.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori duke theksuar se nuk qëndron pretendimi i debitorit se dokumenti bë bazë të së cilit është marrë urdhri për përmbareim nuk ka tipare të përmbareueshmërisë sepse është vetëm përshkrim i dispozitës ligjore, përkundrazi dokumenti është konform dispozitës ligjore së nenit 29.3 të LPP-së, respektivisht dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbareim sepse me të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, si dhe është dokumenti i besueshëm konform dispozitës së nenit 29 par.1 pika 1.2 të LPP-së sepse në shkresa të lëndës janë faturat dhe kartela e parapaguesit – debitorit. Ka shtuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit se ka kaluar afati kohor brenda të cilit sipas ligjit mund të kërkohet përmbareimi për faktin se propozimi për përmbareim është paraqitur në afatin e përcaktuar, saktësisht me datë 19.04.2019 dhe për faturat Maj 2018, Dhjetor 2018 ndërsa debitori ka paguar në mënyrë suksesive dhe pjesërisht borxhin.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, me aktvendimin PPP.nr.162/19 të datës 15.10.2021 ka vendosur që ta aprovoj tërësisht si të bazuar

prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga shkresat e lëndës nuk ekziston kontrata e ushtruar në mes të debitorit dhe kreditorit, nuk është bashkëngjitur asnjë faturë për të treguar se është nënshkruar nga kreditori dhe debitori, të cilat kishin për të qenë dokumente të besueshme për përmbarrim, përveç se janë evidentuar në listat e transaksioneve. Në propozim për përmbarrim, kreditori nuk ka bashkëngjitur asnjë dokument që i plotëson kushtet për përmbarrim dhe nuk i ka tiparet e përmbarrueshmërisë të parapara me nenin 22, 27 dhe 29 të LPP-së për të qenë i përmbarrueshëm dhe i përshtatshëm për përmbarrim. Më tej, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se dokumenti në bazë të cilit është lëshuar urdhri për përmbarrim nga ana e përmbarruesit privat, fatura me nr. ///////////////në emër të debitorit M.Gj nga K. ku është përcaktuar shuma e borxhit prej 102.04 euro nuk mund të konsiderohet si dokument përmbarrimor sepse faturës i mungon nënshkrimi nga ana e debitorit, prandaj mosnënshtrimi dhe pranimi i faturës këtë dokument e bëjnë jo të besueshëm dhe si i tillë nuk mund të përmbarrohet.

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 2 pika b), g), j), k), dhe m) të LPK-së dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të kreditorit se aktvendimi i atakuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) të LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktvendimit të ankimuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e dhëna, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për aprovimin pjesërisht të prapësimin të debitorit dhe shfuqizimit të urdhrin përmbarrimor PPP.nr.162/19 të datës 15.10.2021, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet.

Drejtë dhe në mënyrë të plotë nga gjykata e shkallës së parë është vërtetuar dhe konstatuar gjendja faktike dhe aktvendimi i atakuar nuk përmban as shkelje të dispozitave të Ligjit të Procedurës Përmbarrimore dhe Ligjit të Procedurës Kontestimore sipas pretendimeve ankimore të kreditorit përmes ankesës së paraqitur.

Gjykata e Apelit e ka vlerësuar mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike përmbarrimore nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe ka gjetur se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë, kur ka shfuqizuar urdhrin për lejimin e përmbarrimit P.nr.54/19 i datës 26.04.2019, të lejuar nga Përmbarruesi Privat ngase faturat e përshkruara në propozimin për përmbarrim të datës 25.04.2019, e të cilat kërkohet të përmbarrohen, nuk i plotësojnë kushtet për t'u konsideruar të përshtatshme për përmbarrim. Duke pasur parasysh nenin 20, paragrafi 1.1.17 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2010, për zbatimin e Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, përcaktohet se: "në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është në dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruaj faturën tatimore", ashtu që në rastin konkret, nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës,

shihet se dokumenti i besueshëm - faturat në bazë të cilave është lejuar përmbarimi, nuk janë nënshkruar nga debitori i përmbarimit. Nënshkrimi i faturës nga palët në marrëdhënie detyrimi, nuk paraqet vetëm një formalitet, por një veprim i tillë nënkupton pranimin e punëve të kryera nga kreditori dhe pohimin se ekziston borxhi i debitorit ndaj kreditorit konform faturave, andaj duke qenë se në rastin konkret faturat nuk janë nënshkruar, do të thotë se debitori nuk i ka pranuar ato fatura si të vetat, dhe si rrjedhojë të njëjtat nuk i përmbushin kushtet për të qenë të përshtatshme për përmbarim konform dispozitave të ligjeve në fuqi.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes sipas aktvendimit të ankimuar ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.9805/21 me datë 29.01.2024

Gjyqtarja
Frosina Sylejmani